

Arben Avdyli -Biografia

Z. Avdyli ka më shumë se 20 vite përvojë në sektorin financiar të Kosovës, respektivisht në atë bankar, mikrofinanciar dhe të sigurimeve. Fillimisht me organizata joqeveritare duke kontribuar në sektorin e zhvillimit të bizneseve në vend (Mercy Corps), për të vazhduar më tutje në institucione mikrofinanciare në të mirë të përmirësimit të sektorit mikrofinanciar (AFK). Më tutje karrierën e tij si bankier, e vazhdon me pozitën e Senior Menaxher Regjional (Pro Credit Bank), duke treguar profesionalizëm në menaxhimin dhe ndërtimin e kapaciteteve njerëzore dhe të biznesit në sektorin bankar në Kosovë. Ai, gjithashtu ka udhëhequr dhe realizuar me sukses shumë projekte të mëdha me qëllim të përkrahjes së zhvillimit ekonomik në vend, në sektorin privat si në fushën e prodhimitarisë, shërbimeve dhe tregtisë si Anëtarë Bordi dhe menaxher i projekteve të ndryshme. Pastaj vazhdon në sektorin mikrofinanciar, si Udhëheqës Regjional dhe zhvillues produktesh në FINCA, duke pasuruar edhe më shumë përvojën e tij në tregun financiar.

Në industrinë e Sigurimeve e fillon kontributin e tij me pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv-CEO, në SCARDIAN SH.A. Me angazhimin profesional të tij si CEO dhe konsulent bordi, dha kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin e biznesit në kompani dhe në industrinë e sigurimeve. Në vitin 2020 e vazhdon kontributin e tij në industrinë e sigurimeve, në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv-CEO në Kompaninë e Sigurimeve "SIGURIA" Me objektivat dhe prioritetet e caktuara, ai gjithnjë angazhohet së bashku me stafin e KS SIGURIA, që me shërbime efikase, mirëbesim, kujdes ndaj klientëve dhe bashkëpunëtorëve të ruaj dhe të ngris sa më lartë imazhin e kompanisë dhe të zhvilloj biznesin në kompani.

Përvoja e tij e larmishme në sektore të ndryshme, i mundëson që me përvojat e tij, të jetë njohës i mirë i funksionimit të tregut bankar, industrisë së prodhimit dhe atë të sigurimeve. Gjithnjë i angazhuar në shërbim të zhvillimit ekonomik, gjatë përvojes së tij, dëshmoj sukses dhe profesionalizëm në pozitat udhëheqëse të tij, duke instaluar kultur moderne menaxheriale.

Ai mban titullin Master në Financa dhe Kontabilitet, i diplomuar në Universitetin e Prishtinës. Ka përfunduar Akademinë Ndërkombëtare Bankier i Çertifikuar të Procredit Bank në Furth të Gjermanisë, me fokus kryesor në menaxhimin financiar, menaxhim risku dhe mjedisi, operacione bankare, menaxhim stafi etj. Është teknik i çertifikuar kontabilitetit ndërkombëtarisht nga IKAF Institute, sipas standardeve ndërkombëtare në fushën e financave dhe raportimit financiar. Studimet Bachelor, Banka Financa i ka përfunduar në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Prishtinës si dhe Çertifikatë Ndërkombëtare si Ekspert i Çertifikuar i Sigurisë së Teknologjisë Informative .

Gjatë karrierës së tij në zhvillimin profesional, ai ka qenë pjesëmarrës në shumë trajnime të zhvillimit profesional si: Analiza Financiare, Shkrim Akademik, Menaxhim i projekteve, Trajnim për trajner, Trajnim i Udhëheqjes Profesionale, Të bërit biznes, Strategjia e Shitjes etj.

Arben Avdyli -Kryeshef Ekzekutiv-CEO-KS SIGURIA

Z.Arbeni Avdyli ka më shumë se 20 vite përvojë në sektorin financiar të Kosovës, respektivisht në atë bankar, mikrofinanciar dhe të sigurimeve. Fillimisht me organizata joqeveritare (Mercy Corps International 1999), për të vazhduar më tutje në institucione mikrofinanciare (njëri ndër themeluesit e AFK). Me 2003 emërohet në pozitën e Menaxherit Regjional (Pro Credit Bank – nivel senior të menaxhmentit). Gjithashtu ka udhëhequr dhe realizuar me sukses shumë projekte si Konsulent dhe Anëtarë Bordi në sektorin privat, në fushën e prodhimit, ndërmjetësimin e shitblerjeve të bizneseve, shërbimeve dhe tregtisë . Në 2014 bëhet pjesë e FINCA International, si Udhëheqës Regjional dhe zhvillues produktesh, duke pasuruar edhe më shumë përvojën e tij në tregun financiar. Industrisë së Sigurimeve iu bashkangjiti në 2016, në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv, në SCARDIAN SH.A., pastaj nga viti 2020, në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv-CEO në Kompaninë e Sigurimeve “SIGURIA”. I diplomuar në Fakultetin Ekonomik – Universiteti i Prishtinës, mban titullin Master i Arteve në Financa dhe Kontabilitet – Universiteti i Prishtinës, ka përfunduar Akademinë Regjionale të Evropës Juglindore të Procredit Bank - Shkup, Akademinë Ndërkombëtare “Bankier i Çertifikuar” të Procredit Bank në Furth të Gjermanisë, me fokus kryesor në menaxhimin financiar, të riskut, të mjedisit, të operacioneve bankare dhe menaxhim të stafi. Është teknik i çertifikuar kontabilitetit dhe posedon Çertifikatë Ndërkombëtare si Ekspert i Çertifikuar i Sigurisë së Teknologjisë Informativë. Gjatë karrierës së tij në zhvillimin profesional, ai ka qenë pjesëmarrës në shumë trajnime të zhvillimit profesional si: Analiza Financiare, Shkrim Akademik, Menaxhim i projekteve, Trajnim për trajner, Trajnim i Udhëheqjes Profesionale, Të bërit biznes, Strategjia e Shitjes etj.

Përvoja e tij e larmishme në sektore të ndryshme, i mundëson që të jetë njohës i mirë i funksionimit të tregut bankar, industrisë së prodhimit dhe atë të sigurimeve dhe kontribues në instalimin e kulturës moderne menaxheriale në industrinë financiare.

Arben Avdyli, i lindur në Janar 1973 në Pejë, i martuar dhe baba i tre fëmijëve padyshim se bën pjesë në grupin e profesionistëve të mirëfilltë që ofron Kosova. Në pozitën aktuale, Z.Arben Avdyli sjell me vete një përvojë mbi 20 vjeçare të ndërtuar kryesisht në sektorin financiar të Kosovës. Duke filluar angazhimin e tij qysh në vitin 1999 me Mercy Corps International, Z. Avdyli ka qenë njëri ndër themeluesit e Agjencionit për Financim në Kosovë (AFK) për të vazhduar në pozitën seniore menaxhuese, Menaxher Regjional i bankës ProCredit Bank për regjionet Pejë – Gjakovë. Në 2014 i bashkohet FINCA International në pozitën Udhëheqës Regjional dhe Zhvillues i Produkteve. Në industrinë e sigurimeve Z. Avdyli për herë të parë, në mënyrë të drejtpërdrejtë përfshihet në vitin 2016 duke marrë përsipër drejtimin e Kompanisë së Sigurimeve SCARDIAN Sh.A. në cilësinë e Kryeshefit Ekzekutiv. Pozita e Kryeshefit Ekzekutiv në Kompaninë SIGURIA ka qenë një progres i natyrshëm dhe i mirëpritur për Z. Avdyli.

Natyrisht, përvoja e krijuar në industrinë financiare e Z. Avdyli komplementohet edhe me përvojën nga veprimtaritë prodhuese ku gjatë karrierës së tij ka shërbyer në pozita të ndryshme duke përfshirë edhe rolin e anëtarit dhe të këshilltarit të bordit drejtues.

Kjo përvojë është e bazuar në edukimin formal të Z. Avdyli i cili ka përfunduar studimet universitare dhe pas universitare në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Z. Avdyli mban titullin akademik: Master i Arteve në Financa dhe Kontabilitet. Edukimin formal z. Avdyli e ka fortifikuar edhe me trajnime të specializuara duke përfunduar Akademinë Regjionale të Evropës Juglindore të Procredit Bank – Shkup; Akademinë Ndërkombëtare “Bankier i Çertifikuar” të Procredit Bank në Furth të Gjermanisë. Për më shumë, Z. Avdyli është teknik i çertifikuar i kontabilitetit dhe posedon Çertifikatë Ndërkombëtare si Ekspert i Çertifikuar i Sigurisë së Teknologjisë Informative.

Edukimi i Z. Avdyli i kombinuar me përvojën e pasur dhe të larmishme, e bën një ekspert të spikatur për të cilin SIGURIA ka pritje të mëdha në të ardhmen gjatë rrugëtimit të përbashkët.

Z.Avdyli, CEO në SIGURIA SHA, me përvojë mbi 20 vjeçare, në sektorin financiar të Kosovës në: mikrofinanca, banka dhe sigurime, kryesisht në pozita të larta udhëheqëse. Mban titull akademik: Master i Arteve në Financa dhe Kontabilitet, "Bankier i Çertifikuar" Gjermani dhe shumë trajnime të tjera të specializuara. Edukimi i Z. Avdylit i kombinuar me përvojën e pasur dhe të larmishme, e bën një ekspert të spikatur për të cilin SIGURIA ka pritje të mëdha në të ardhmen gjatë rrugëtimit të përbashkët.